

Riccardo Butini është Profesor i Projektimit Arkitektonik dhe Urban prej vitit 2009 në Fakultetin e Arkitekturës në Universitetin e Firencës, pranë të cilit, në vitin 2004 ka mbrojtur Doktoraturën me titull: "Projektim Arkitektonik dhe Urban". Nga 2017 është Koordinator i Seksionit të Projektimit Arkitektonik pranë Departamentit të Arkitekturës DIDA, në Universitetin e Firences.

Nga shtatori 2019 është Përgjegjës i Departamentit të Arkitekturës në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në Tiranë dhe Përgjegjës për Marrëveshjen Ndërkombëtare ndërmjet Universitetit të Firencës dhe Universitetit Shtetëror të Shën Petersburgut të Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit.

Puna e tij humbuese është zhvilluar kryesisht pranë Departamentit të Projektimit Arkitektonik, në bashkëpunim me Njësinë e Kërkimit "*DM\_SHS Documentation and Management of Small Historical Settlements*", "*Laboratorio CHM Cultural Heritage Management*" dhe fokusohet në këto akse studimore: "Projekti në kontekstin historik", "Ndërtimi në peizazhin italian". "Vështrimi, materia," Projektimi në peizazhin arkeologjik". Gjithashtu, është Përgjegjës Shkencor i marrëveshjeve për kërkimin shkencor me administratën publike dhe kërkimore: "*Origini anonime del costruire nel Novecento in Italia*" (2016-2017)

Krahas punës didaktike të zhvilluar në Laboratorët e Projektimit Arkitektonik renditen pjesëmarrja dhe aktivitetet në Seminare dhe workshop – në fushën e studimit. Ndër më të spikaturat janë: Workshop Ndërkombëtar "*A facade for San Lorenzo*", i organizuar nga Departamentit të Arkitekturës në Universitetin e Firencës dhe Universitetit Shtetëror të Shën Petersburgut të Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit, Firenze (2018); Workshop Ndërkombëtar "*La pietra tra tradizione e innovazione*", i organizuar nga Departamenti i Arkitekturës (Universiteti Roma Tre), Universidad Politecnica de Madrid, Romë (2016); Workshop Ndërkombëtar "*Costruire nel costruito. Una residenza per studenti universitari*", i organizuar nga Departamenti i Arkitekturës (Universiteti Roma Tre) dhe Universidad de Boyacá, Romë (2016).

Në vitin akademik 2018-2019 ka punuar si Profesor pranë Master-it të Nivelit të II-të "Dokumentim dhe menaxhim i trashëgimisë kulturore" i organizuar nga DIDA, Departamenti i Arkitekturës, Moduli - Projekti Bashkëkohor në kontekstin historik, pranë Shkollës së Arkitekturës në Universitetin e Firences.

Nga viti 2003 deri në 2007 ka punuar si Tutor i Laboratorit të Projektimit në Masterin pas universitar në Teologjinë dhe Arkitekturën e Kishave "*Progettisti di Chiese per il terzo millennio*", i organizuar nga Fakulteti i Teologjisë së Italisë Qendrore dhe Fakulteti i Arkitekturës në Universitetin e Firences.

Ka marrë pjesë në aktivitete si: ditët studimore, konferenca, ligjërata dhe kongrese; më të spikaturat janë: "*The contemporary architecture in Florence*", Summer School Tongji University - Universiteti i Firencës, Firenze (2019); në konferencën "*Habitar el paisaje de la Historia. El proyecto de la plaza de la Constitución de Yátova*", Sala El Lavadero, Yatova (2017); në konferencën "*Potsdam, Fachhochschule Potsdam*" (2013); Dita Ndërkombëtare e Studimit "*Strategie per la salvaguardia e la valorizzazione degli insediamenti medievali*", Pescia (2012); në konferencën "*Michelucci dopo Michelucci*", Firenze 2010; Konferencën e 6-të "*Identità dell'architettura italiana*", Firenze, (2008).

Anëtar i Bordit të Profesorëve për Studimet Doktorale pranë Shkollës së Arkitekturës së Firences, kurrikulave të projektimit arkitektonik dhe urbanistik, ku zhvillon edhe aktivitetet didaktike në ciklet e leksioneve "Costruire & ricostruire" me leksionin e titulluar:

"*Të rindërtosh qytetin. Giovanni Michelucci dhe studimet për zonën Ponte Vecchio*".

Anëtar i bordit shkencor të revistës shkencore "*EVOLUTION, Journal of the Life Sciences and Society*" të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në Tiranë.

Redaktor i revistës shkencore *FIRENZE ARCHITETTURA* botim i Departamentit të Arkitekturës DIDA, pranë Universitetit të Firencës.

Librat e tij më të spikatur: *Giovanni Michelucci. Fotogrammi del museo* (2007), *Luoghi dell'abitare. Tham & Videgard Arkitekter* (2012), *Architettura Sacra. Paolo Zermani* (2014), *Cinque Architetture* (2016) e *Progetto contemporaneo nel paesaggio archeologico* (2016) e *Architetture Possibili* (2019).

Artikuj shkencor dhe projektet të botuara në revista dhe tekste të arkitekturës:

*la Nuova Sede della Società di Castelsenio* (2004), *la Sede direzionale e produttiva* (2008), *le Case a Carpineto* (2014), *il Centro per le arti visive ex-distilleria Lo Stellino* (2016) e *architettura temporanea Sotto le Logge del Papa* (2018).

Pjesëmarrje në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare të arkitekturës.